



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.107

17 korrik

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.630, datë 11.6.2009

Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të
vitit 2008”..... 5227

VENDIM
Nr.630, datë 11.6.2009

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR “PËR NDIHMAT SHETËRORE
TË VITIT 2008”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja “dh”, 18, shkronja “e”, dhe 32, pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të vitit 2008”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELAT

Tabela 1	Treguesit ekonomike për periudhën 2000-2008
Tabela 2	Vendimet e KNSH për skemat ekzistuese, skemat e reja dhe ndihmat individuale
Tabela 3	Ndihma shtetërore në Shqipëri (përfshirë bujqësinë dhe peshkimin) për vitet 2006-2008
Tabela 4	Ndihma shtetërore në Shqipëri për vitet 2006-2008 (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin)
Tabela 5	Ndihma shtetërore në Shqipëri në total krahasuar me mesataren në BE
Tabela 6	Klasifikimi sipas kategorive të ndihmës shtetërore në Shqipëri, për vitet 2006-2008 (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin)
Tabela 7	Klasifikimi sipas kategorive të ndihmës shtetërore në Shqipëri, për vitet 2006-2008 (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin)
Tabela 8	Ndihma Shtetërore në Shqipëri e klasifikuar sipas instrumenteve
Tabela 9	Shpërndarja e ndihmave horizontale në Shqipëri
Tabela 10	Ndihma shtetërore horizontale në Shqipëri krahasuar me mesataren e BE-së
Tabela 11	Shpërndarja e Ndihmës Sektoriale në Shqipëri

TABELA E SHKURTIMEVE

CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së lirë të Evropës Qendrore
PE	Parteneriteti European
KE	Komuniteti European
BE	Bashkimi European
GATS	Marrëveshja e Përgjithshme për Shërbimet Tregtare
GATT	Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë
PPB	Prodhimi i brendshëm bruto
MP	Marrëveshja e Përkohshme
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
NUTS	Nomenklatura e Njësive Statistikore Territoriale
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
KNSH	Komisioni i Ndihmës Shtetërore
DNSH	Drejtoria e Ndihmës Shtetërore
SCMA	Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese
SME	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

KAPITULLI 1

HYRJE

Detyrimet ndërkombëtare për ndihmën shtetërore në Shqipëri, përfshirë kërkesat për transparencë dhe raportimin ndërkombëtar, burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian dhe shtetet anëtare, nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) 2006, si dhe nga Marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese (SCMA) në kuadër të OBT-së.

Legjislacioni i ndihmës shtetërore (ligji dhe rregulloret në zbatim të tij) hyri në fuqi në janar 2006¹, periudhë prej së cilës vepron dhe sistemi kombëtar i ndihmës shtetërore për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin. Në bazë të nenit 17(f) të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, KNSH ka detyrimin të hartojë, me ndihmën e DNSH-së, raportin vjetor për ndihmat shtetërore dhe ta paraqesë atë pranë Këshillit të Ministrave, i cili, pasi e miraton, e përcjell në Komisionin Evropian. Raporti për ndihmat shtetërore në RSH për vitin 2008 është përgatitur në përputhje me këto dispozita ligjore dhe kërkesat e MSA-së dhe CEFTA-s.

Raporti i dytë i ndihmave shtetërore jep një përshkrim të objektivave kryesore që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumenteve të përdorura në periudhën 2006-2008. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2006-2008 është vlerësuar në rreth 21 miliardë lekë (≈170 milionë €). Ndihma shtetërore për vitin 2008, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në 4.3 miliardë lekë (27.3 milionë €), që përfaqësojnë 0.4 % të PPB-së të Republikës së Shqipërisë. Duhet të theksohet se pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin “*De minimis*” të BE-së dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Sikundër është vënë re në Raportin e Parë të Ndihmës Shtetërore, paraqitja e të dhënave të ndihmës shtetërore duhet parë në një kontekst dinamik, duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Shqipëria po lëviz drejt një qasje shumë më të strukturuar ndaj politikës së saj industriale që mund të ndryshojë modelet e mëparshme të shpërndarjes së ndihmave, apo skemat që do të zbatohen. Kjo lidhet në veçanti me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2008-2013)², e cila, ndër të tjera, u tregon apo u sugjeron autoriteteve shqiptare të përgatisin skema të projektuara dhe orientuara në bazë të zhvillimit shumë vjeçar dhe që të synojnë drejt zhvillimeve strategjike të ekonomisë, duke vendosur prioritetë të pranuar nga të gjithë.

¹ Ligji nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”

² Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2007-2013, Mars 2008

KAPITULLI 2

ZHVILLIMET KRYESORE RREGULLATORE DHE POLITIKE NË LIDHJE ME NDIHMËN SHTETËRORE NË SHQIPËRI NË 2008

Situata ekonomike në Shqipëri

Ndihma shtetërore në Shqipëri duhet të konsiderohet brenda kontekstit të vet ekonomik dhe të zhvillimit. Pavarësisht krizës ekonomike globale, ekonomia shqiptare ka pasur një performancë krahasimisht pozitive gjatë vitit 2008 dhe ekonomia e vendit është rritur në përputhje me parashikimet e fillim vitit, me një rritje të PPB vlerësuar në 6,9%. Kjo rritje ka reflektuar dinamikën e zhvillimit të disa sektorëve të ekonomisë, të mbështetur nga rritja e konsumit, investimeve dhe përmirësimit konstant strukturor dhe infrastrukturor të ekonomisë.

Rritja më e lartë vjetore u vu re në ndërtim dhe tregti, ndërsa industria, transporti dhe komunikacionit paraqesin një ngadalësim, në krahasim me vitin e mëparshëm. Tremujori i fundit paraqiti një tablo të ndryshme cilësore për sa i përket zhvillimit ekonomik. Veprimtaria ekonomike shfaq shenja ngadalësim, për shkak të ndikimit të krizës globale ekonomike dhe financiare, ndërkohë që edhe treguesit monetarë pësuan një paqëndrueshmërie të konsiderueshme.

Rritja ekonomike e vendit është mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila mbetet gjeneratori kryesor i rritjes ekonomike. Konsumi, investimet dhe shpenzimet qeveritare u rritën në 2008. Për sa i përket kërkesës së jashtme, në formën e eksporteve, megjithëse pati një rritje të shpejtë gjatë viteve të fundit, ende mbetet në nivele të ulëta për të mbështetur, në vazhdimësi, rritjen ekonomike të vendit. Veprimtaria ekonomike e vendit është financuar kryesisht nga burime të brendshme. Norma mesatare vjetore e inflacionit, për vitin 2008, është 3,4 %. Viti 2008 u karakterizua nga një rritje e shkëmbimeve ekonomike dhe tregtare.

Për më tepër, gjatë vitit 2008 politika fiskale ishte më ekspansioniste, gjë që u pasqyrua në zgjerimin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Gjatë vitit 2008, deficitit buxhetor ka arritur në masën 5,66% të PPB-së. Borxhi publik arriti në nivelin 55,9 përqind të PPB-së, nga 52,8 për qind në vitin e mëparshëm. Buxheti i të hyrave dhe shpenzimeve u rrit respektivisht në 15,3 dhe 22,6 për qind gjatë vitit 2008, duke përbërë 27,3 dhe 32,9 për qind të PPB-së.³

Treguesit kryesore ekonomike në periudhën 2006 - 2008 janë treguar në Tabelën 1 më poshtë.

³ Fjalimi i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë Ardian Fullani, gjatë prezantimit të Raportit Vjetor 2008 në Komsionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës.

Tabela 1: Treguesit kryesorë ekonomikë për periudhën 2006-2008⁴

Treguesit makro-ekonomik	2006	2007	2008
Rritja reale e PPB (në %)	5,5	6,0	6,9
PPB (me çmimet korrente, në miliard LEK)	896.300	956.314	1.086.000
PPB (në milion Euro)	7243,00	8014,00	8843,00
Popullsia (në milion banorë)	3,15	3,16	3,17
PPB (për frymë në Euro)	2302,29	2534,47	2789,59
Numri i të punësuarve (në mijë)	935,00	965,55	970,00
Përqindja e papunësisë	13,80	13,18	12,60
Norma e inflacionit	2,40	2,90	3,40
Deficiti Buxhetor (në % ndaj PPB)	-3,30	-3,50	-5,66
Borxhi publik (në % ndaj PPB)	2,33	1,75	1,66
Financim i jashtëm (në % ndaj PPB)	0,65	0,54	3,35
Financim i brendëshëm (në % ndaj PPB)	2,65	2,95	2,31
Llogaria korrente (në % ndaj PPB)	-7,20	-10,00	-14,90
Kursi mesatar i këmbimit, LEK/EURO	123,01	121,78	122,80

PPB për frymë e Shqipërisë është afërsisht 22%⁵ e mesatares së 27 vendeve të BE-së. Ky është një tregues që tregon se si duhet të trajtohen në vitet e ardhshme, mangësitë në zhvillimin e vendit dhe, veçanërisht, prapambetja serioze e zonave të caktuara. Aktualisht, në Shqipëri ka shumë sfida për zbatimin e politikave ekonomike. Përveç ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, ato përfshijnë nevojën për të përmirësuar mjedisin e biznesit, për të rritur cilësinë e arsimit dhe për të mundësuar trajnimin e burimeve njerëzore, përmes zbatimit të standardeve që nxisin të mësuarit, inovacionin dhe krijimtarinë në biznes. Është e domosdoshme të punohet për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, në mënyrë që të përshtatet me logjikën e ndërkombëtarizimit dhe integritit në tregjet globale. Futja e teknologjive të reja, diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve ekzistuese, rritja e standardeve dhe prodhimi i produkteve me vlerë të shtuar, janë disa nga rrugët që do të mundësojnë arritjen e këtij objekti.

Strategjitë dhe Planet e Zhvillimit

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2008-2013 u miratua nga Këshilli i Ministrave në mars 2008. Strategjia përqendrohet në arritjen e një zhvillimi të balancuar, të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, në rritjen ekonomike dhe shtimin e punësimit. Strategjia synon, veçanërisht, ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës bazë, ndërtimin e një kuadri mbështetës për biznesin dhe rritjen e mundësive për punësim edhe për kategoritë në vështirësi, që do t'i shërbejnë përfshirjes së tyre në jetën shoqërore të vendit. Për përmbushjen e objektivave ekonomike afatmesme, strategjia parashikon një sërë nismash që synojnë rritjen e qëndrueshme ekonomike, prodhimin dhe rritje të aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve, përmes zhvillimit dinamik të tyre, nxitjen e investimeve dhe përdorimin sa më eficient të burimeve natyrore, njerëzore dhe financiare.

⁴ Burimi: INSTAT, Ministria e Financave (vlerësim paraprak), FMN dhe Banka e Shqipërisë (Raporti Vjetor 2008)

⁵ Burimi: Raporti i Stabilizim Asociimit 2008

Në vizionin më të fundit për zhvillimin ekonomik në Shqipëri, qeveria ka pranuar nevojën për një koordinim të politikave ekonomike nga të gjitha institucionet, si dhe përcaktimin, në mënyrë të efektshme të masave konkrete, për të garantuar zbatimin e tyre. Përparësi është përmirësimi i imazhit të Shqipërisë, si destinacion për investim, intensifikimi i investimeve në infrastrukturë, e cila vazhdon të jetë me probleme, mbështetja ndaj SME-ve, krahas një strategjie moderne të zhvillimit rajonal, që është e nevojshme për të nxitur rritjen e mëtejshme të ekuilibruar të zonave dhe qarqeve të vendit, si dhe krijimin e vendeve të punës.

Duke qenë se këto nisma do të merren në vitet e ardhshme, ka gjasa që të miratohen skema të tjera të ndihmës shtetërore, përveç atyre që janë vënë në dukje në këtë raport. Në përputhje me këtë, edhe pse ndihmat shtetërore në Shqipëri aktualisht janë të ulëta (0.4% e PBB-së), ekziston mundësia për një rritje të përgjithshme të ndihmës shtetërore në Shqipëri, pasi vendi shkon përpara në rrugën e zhvillimit, të parashikuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe nga strategjitë e ndryshme sektoriale, duke përfshirë ato të lidhura me politikën industriale, turistike dhe zhvillimin rajonal. Për më tepër, për shkak të krizës botërore, po vendosen kufizime në shpenzimet publike, në mbarë botën, ndonëse qeveritë janë detyruar të marrin masa të ndihmës shtetërore (veçanërisht në sistemin bankar) për të zbutur këto dështime të tregut. Ndërsa nuk ka shenja të qarta të ndikimit të këtyre faktorëve në Shqipëri për momentin, këto konsiderata ka të ngjarë që të marrin rëndësi në vitet e ardhshme lidhur me modelet e ndihmës shtetërore në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, thekson, gjithashtu, angazhimin e qeverisë për të përcaktuar përparësitë në forcimin e kontrollit të strukturave të ndihmës shtetërore në vend.

Sfidat Sektoriale në Shqipëri

Raporti Vjetor i Ndhimave Shtetërore për vitin 2007 ofron një pasqyrë të disa drejtimeve kryesore të zhvillimit të politikave sektoriale të qeverisë në fushat e transportit, energjisë, zhvillimit rajonal, investimet e huaja, zhvillimin e SME-ve, punësimin, turizmin dhe kulturën.

Gjatë vitit 2008 kanë vazhduar procedurat e privatizimit të pronës shtetërore dhe uljen e rolit të saj në ekonomi. Për këtë arsye, përparësi merr forcimi i mekanizmave të tregut, në mënyrë që të shmangen dështimet e tregut dhe shtrembërimi në konkurrencë. Në ndikim të ndjeshëm, në këtë drejtim, do të kishte edhe përmirësimi i mjedisit të biznesit. Ngritja dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në vitin 2007, jo vetëm ka reduktuar kohën e nevojshme për të regjistruar një biznes në një ditë të vetme, por ofron edhe kryerjen e njëkohshme të regjistrimeve për qëllime të administrimit të taksave, të sigurimeve shëndetësore dhe sociale, si dhe të Inspektoratit të Punës. Infrastruktura e shërbimeve për regjistrimin e biznesit u përmirësua me rritjen e numrit të shërbimeve elektronike dhe hapjen e qendrave të regjistrimit në të gjithë vendin. Gjithashtu, vazhdon reforma për përmirësimin e cilësisë së fuqisë punëtore, duke vënë theksin në formimin profesional.

Struktura sektoriale e ekonomisë ka mbetur e pandryshuar, ku pjesën kryesore e zë sektori i shërbimeve. Sektori i minierave ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen totale të prodhimit dhe eksporteve, edhe pse prodhimi ndaj totalit ka qëndruar relativisht i ulët. Sektori i bujqësisë ka mbetur punëdhënësi më i madh, me 58 % të totalit të punësuarve, por duke kontribuar vetëm në 20,7% të PPB-së (sipas të dhënave të vitit 2007). Në përgjithësi, ekonomia ka ruajtur strukturën e saj, duke lënë hapësirë për zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe sektorëve industriale⁶.

⁶ Burimi: Raporti i Stabilizim Asociimit 2008

Detyrimet ndërkombëtare në lidhje me ndihmën shtetërore⁷

Detyrimet e Shqipërisë për një sistem rregullator transparent lidhur me ndihmat shtetërore dhe subvencionet (duke përfshirë edhe raportimet) rrjedhin nga MSA-ja⁸, MP⁹, Vendimi i Partneritetit European i nëntorit 2007¹⁰, Marrëveshja e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërbalacuese¹¹, si dhe Marrëveshja e CEFTA-s (2006)¹².

Megjithëse detyrimet ndërkombëtare kanë nxitur Shqipërinë për të përshtatur subvencionimin dhe ndihmat shtetërore me normat dhe praktikat ndërkombëtare, arsyetimi për futjen e këtij sistemi ka një dimension kombëtar që është tejet e rëndësishme për Shqipërinë dhe thuajse e pavarur nga faktorët e jashtëm. Në mënyrë të veçantë, ndihmat shtetërore dhe subvencionet në Shqipëri po shihen gjithnjë e më shumë si lehtësim i shpenzimeve të burimeve të pakta buxhetore, për të realizuar në mënyrë efikënte programet e zhvillimit brenda vendit dhe për të shmangur shpërdorimin e fondeve publike

Në drejtim të raportimit, MSA dhe MP kërkojnë raportim të rregullt reciprok, pra kërkojnë transparencë ndërkombëtare në lidhje me të gjitha masat e marra nga autoritetet administrative në nivel lokal dhe qendror, si dhe nga institucionet e tjera që veprojnë në emër të shtetit, lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore. Ndërsa në BE tashmë funksionon një mekanizëm raportues i detajuar/ transparent vjetor për ndihmat shtetërore, në Shqipëri kjo ka filluar në vitin 2008. Raporti Vjetor i Ndihamave Shtetërore për vitin 2007¹³ është në përputhje me këto detyrime. Edhe në sistemin e OBT-së, është standard, përgatitja e raporteve të detajuara për subvencionet industriale, kërkesë, të cilën Shqipëria e plotësoi në mars 2008.

Vendimi i Partneritetit Evropian në shkurt 2008¹⁴ thekson, ndër të tjera, rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për ndihmën shtetërore dhe përditësimin e vazhdueshëm inventarit të skemave të ndihmës shtetërore. Në një periudhë afatmesme, vendimi i Partneritetit Evropian kërkon t'i jepet përparësi zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe përfundimin e alinjmimit të skemave të ndihmës shtetërore me rregullat e BE, siç theksohet në Marrëveshjen e Përkohshme. Prioritetet afatshkurtra të PE pritet të realizohen deri në fillim të 2010 dhe prioritetet afat-mesme deri në fillim të 2012. Vazhdimi i zbatimit të sistem rregullator të ndihmës shtetërore dhe zgjerimi i mëtejshëm i saj në vitin 2008 është realizuar në përputhje me këto udhëzime.

⁷ Për detaje të mëtejshme të shihet Kapitulli 3 I Raportit Vjetor të Ndihamave Shtetërore të vitit 2007

⁸ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Komunitetit European dhe Shteteve Anëtare, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në 12 qershor 2006.

⁹ Marrëveshja e Përkohshme midis Komunitetit European dhe Shteteve Anëtare, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, OJL 239 1 shtator 2006.

¹⁰ Vendimi i Këshillit European mbi parimet, prioritet dhe kushtet e Partneritetit European me Shqipërinë dhe shfuqizimin e Vendimit 2006/54/EC, COM (2007) 656 përfunduar 6 nëntor 2007.

¹¹ Marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalacuese, 1994, Sekretariati GATT (1994) Rezultatet e Raundit të Uruguait për negociata tregtare shumëpalëshe, teksti ligjor, Gjenevë, "Marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalacuese", pp. 264-314.

¹² Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (2006) Marrëveshja për Amendimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lire të Evropës Qendrore (CEFTA), <http://www.stabilitypact.org/wt2/TradeCEFTA2006.asp>

¹³ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1023, datë 09.07.2008 dhe dërguar në Komisionin Evropian dhe CEFTA.

¹⁴ Vendimi i Këshillit European 2008/210/EC 18 shkurt 2008 mbi parimet, prioritet dhe kushtet e Partneritetit European me Shqipërinë.

Zhvillimet kryesore ligjore dhe politike në lidhje me ndihmën shtetërore në vitin 2008

Në fokus të strukturave të kontrollit të ndihmës shtetërore, gjatë vitit 2008, kanë qenë plotësimi i kuadrit ligjor dhe zbatimi i tij . Legjislacioni në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri është në përputhje me rregullat e Bashkimit Europian. Përveç përcaktimit të parimeve dhe procedurave, në bazë të të cilave, jepen dhe kontrollohen ndihmat shtetërore, ai shërben edhe për të arritur një ekuilibër midis politikave që synojnë të nxisin zhvillimin ekonomik dhe social të rajoneve të caktuara apo të gjithë vendit dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e parimeve të ekonomisë së tregut.

Krahas ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe tri rregulloreve në zbatim të tij, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, KNSH ka nxjerrë edhe një sërë udhëzimesh për kategori të caktuara të ndihmës shtetërore. Gjatë vitit 2008 KNSH ka miratuar udhëzimin “ Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”, si dhe atë “Për metodologjinë e analizës së kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit”.

Përsa i takon udhëzimit të parë, ai përcakton kushtet dhe kriteret, në përputhje me të cilat mund të lejohet ndihma shtetërore për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik. Ky udhëzim zbatohet për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe lidhet me sektorin e prokurimeve publike, të konkurrencës, të transportit e punëve publike, apo të transmetimeve telefonike e mediatike.¹⁵

Ndërsa udhëzimi “Për metodologjinë e analizës së kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit” parashtron kriteret që duhet të ndiqen në dhënien e ndihmës shtetërore në sektorin e sigurimit të kreditimit të eksportit, në mënyrë që të ruhet konkurrenca midis siguruesve publikë të kredive të eksportit dhe atyre privatë, që mund të ushtrojnë veprimtarinë në një treg të tillë. Ky udhëzim zbatohet në sektorin e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit dhe nuk gjen zbatim për sigurimin afatmesëm dhe afatgjatë të kredive të eksporteve.¹⁶

Në zbatim të procedurave ligjore, KNSH ka vazhduar shqyrtimin dhe vlerësimin e planeve të reja të ndihmës shtetërore. Vendimet e marra gjatë vitit 2008 nga KNSH, për skemat e reja të ndihmës shtetërore janë paraqitur në tabelën 2.

¹⁵ Ky udhëzim është harmonizuar me OJC 297/4, 29 .11.1994, Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik.

¹⁶ Ky udhëzim është harmonizuar me OJC 281, 17.09.1997, faqe 4-10.

Tabela 2: Vendimet e marra nga KNSH, gjatë vitit 2008, për skemat e reja të ndihmës shtetërore

Nr. Regjistrat	Titulli skemës	Sektori	Vendimi i KNSH
AI/N/006/2008	"Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit"	Produktet industriale dhe agroindustriale	Nr. 24, datë 02.05.2008
AI/N/007/2008	"Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW"	Energjetik	Nr. 25, datë 02.05.2008
AI/N/007/2008	"Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 02.05.2008 "për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW"	Energjetik	Nr. 27, datë 18.08.2008

Shkurtimisht rastet mund të përmbliken si më poshtë:

Rasti nr. 1: Skema synon të krijojë kushte lehtësuese për ndërmarrjet që do të përdorin lëndët djegëse për nevojat teknologjike të prodhimit, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, si dhe për subjektet që kanë serat me ngrohje dhe që përdorin lëndët djegëse mazut e solar.

Skema është e justifikuar për shkak të natyrës së saj, duke qenë se ajo kontribuon në zhvillimin e burimeve alternative të energjisë, që përdoren në sera, si dhe për produktet industriale dhe agroindustriale. Lënda djegëse do të përdoret vetëm për nevoja teknologjike të prodhimit. megjithatë, duke qenë se kjo ndihmë konsiderohet ndihmë operacionale, KNSH e ka miratuar atë, duke vendosur kushte kumulative:

- përjashtimi të jetë i kufizuar në kohë, jo më shumë se 5 vjet;
- përjashtimi të mos jetë selektiv, të mos jepet vetëm për produkte të veçanta industriale apo vetëm për sektorë të veçantë të industrisë; sektori i prodhimit të çelikut nuk mund të përfitojë nga kjo skemë;
- masa të jetë proporcionale dhe të reduktohet nga viti në vit. Rimbursimi total i akcizës të kryhet vetëm për tri vitet e para të zbatimit të skemës, në vitin e katërt të bëhet një rimbursim në masën 80% të akcizës dhe në vitin e pestë një rimbursim në masën 50% të saj.

Rasti nr. 2: Skema synon të krijojë kushte lehtësuese për ndërmarrjet që ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi më të madhe se 5Më, nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse, për të siguruar plotësimin e nevojave me energji në vend. Skema është e justifikuar për shkak të natyrës së saj, duke qenë se ajo kontribuon në zhvillim e burimeve alternative të energjisë, shumë të domosdoshme për një vend me probleme serioze në furnizimin me energji. Edhe kjo skemë hyn në kategorinë e ndihmës operacionale dhe, si të tillë, KNSH e ka miratuar atë duke vendosur kushte kumulative:

- akciza e lëndëve djegëse të përdorura të rimbursohet deri në masën 80%. Pjesa tjetër prej 20% të përballohet nga ndërmarrjet përfituese;
- Investimet që do të përdoren për gjenerimin e energjisë duhet të jenë investime të reja, me teknologji moderne që respekton të gjitha standardet mjedisore;
- Ndihma e përfituar nga kjo skemë, nëpërmjet përjashtimit nga akciza e lëndëve djegëse, nuk mund të përshtohet me asnjë formë tjetër ndihme nga çfarëdo burimi shtetëror;
- Investimet që do të përdoren për gjenerimin e energjisë duhet të jenë investime të reja, me teknologji moderne që respekton të gjitha standardet mjedisore;
- Ndihma e përfituar nga kjo skemë, nëpërmjet përjashtimit nga akciza e lëndëve djegëse, nuk mund të përshtohet me asnjë formë tjetër ndihme nga çfarëdo burimi shtetëror.

Skema nr. 3: Në këtë skemë parashikohen ndryshimet e bëra në skemën nr. 2, si më poshtë vijon:

- Skema e përjashtimit nga akciza për lëndët djegëse, lejohet me kusht që akciza e lëndëve djegëse të përdorura të rimbursohet në masën 100% deri në datën 31 dhjetor 2014. Nga data 1 janar 2015 akciza e lëndëve djegëse të përdorura rimbursohet deri në masën 80%. Pjesa tjetër prej 20% të përballohet nga ndërmarrjet përfituese.
- Investimet që do të përdoren për gjenerimin e energjisë duhet të jenë investime me teknologji moderne që respektojnë të gjitha standardet mjedisore

Krahas punës për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kontrollit të zbatimit të tij, DNSH ka qenë shumë aktive në rishikimin dhe dhënien e mendimeve për projekt-taktet e ndryshme normative që mund të përmbanin elementë të ndihmës shtetërore, nëpërmjet përfshirjes së burimeve shtetërore.

Gjatë vitit 2008, DNSH ka dhënë kontributin e saj për më shumë se 50 akte normative, ku përfshihen projektligje, projektvendime të Këshillit të Ministrave, strategji sektoriale, apo dokumente të politikave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në një pjesë të konsiderueshme, këto janë shoqëruar edhe me pjesëmarrje në tryeza apo takime joformale këshillimore me institucionet qeveritare.

Harta Rajonale e Ndhmës Shtetërore dhe përgatitjet për ndryshimet legjislative

Në kuadër të MSA-së dhe Marrëveshjes së Ndërmjetme, vendi ynë duhet të paraqesë pranë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas shërbimet e Komisionit dhe strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore duhet të shqyrtojnë së bashku përputhshmërinë e rajoneve dhe intensiteteve maksimale të ndihmës që lidhen me to, me qëllim përgatitjen e hartës rajonale për ndihmën shtetërore, mbi bazën e udhëzimeve përkatëse të Komisionit.

Duke qenë se Shqipëria nuk ka një klasifikim statistikor apo rajonal në nivelin NUTS II, si dhe në mungesë të treguesve të PPB-së ndarë në nivel qarku (aktualisht në Shqipëri janë 12 qarqe), gjatë vitit 2008 ka filluar ushtrimi i parë për përgatitjen e kësaj harte. Elementi kyç metodologjik ka qenë një përkufizimi i saktë i zonave të prapambetura rajonale lidhur edhe me disavantazhet e brendshme social-ekonomike.

Në fund të 2008, ka filluar rishikimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore në Shqipëri, duke i paraprirë realizimit të objektivave të vitit 2009, të përcaktuara në *Planin Kombëtar për Zbatimin e*

MSA-së. Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e ndihmës shtetërore vjen si rezultat i reformave të ndërmarra nga BE-ja në këtë fushë dhe ky proces parashikohet të vazhdojë deri në vitin 2011. Shqipëria do të vazhdojë të jetë pjesë e këtyre reformave legjislative, si pjesë e procesit të integritit në BE.

Fuqizimi i kapaciteteve të stafit të DNSH-së

Për sa i takon fuqizimit të kapaciteteve të stafit të DNSH-së, janë zhvilluar sesione trajnimi të brendshëm për stafin e DNSH për çështje që lidhen me fushën e ndihmës shtetërore, të tilla si: hekurudhat, sektori i energjisë, kriteri ekonomik i përdorur në vlerësimin e rasteve apo zonat e lira, të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me programin CARDS 2005 *“Fuqizimi i kapaciteteve në fushën e ndihmës shtetërore”*.

Janë zhvilluar seminare të veçanta trajnimi me përfaqësuesit e ministrive të linjës (siç janë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ALBINVEST-i dhe Drejtoria e Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës). Theksi është vënë në problemet e ndeshura gjatë zbatimit të skemave të ndihmës shtetërore, të miratuara nga KNSH.

KAPITULLI 3

NDIHMA SHTETËRORE NË SHQIPËRI

Vështrim mbi ndihmën shtetërore në Shqipëri në periudhën 2006-2008

Vlera e ndihmës shtetërore në Shqipëri për vitin 2008 llogaritet në 4.3 miliardë lekë. Kjo shumë është reduktuar në krahasim me vitin 2007 (11.4 miliardë lekë) dhe niveli i ndihmës shtetërore në ekonomi mbete ende i ulët, vetëm 0.4% të GDP-së për vitin 2008.

Tabela 3 paraqet treguesit kryesorë që lidhen me ndihmën shtetërore në Shqipëri për tre vitet e fundit (2006-2008).

**Tabela 3: Ndhimja shtetërore në Shqipëri
(përfshirë bujqësinë dhe peshkimin) për vitet 2006-2008**

Emërtimi	Njësia e matjes	Year			Indekset		
		2006	2007	2008	2006	2007/ 2006	2008/ 2006
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		123,70	121,78	122,80			
Ndhimja shtetërore	million LEK	5.036,87	11.442,67	4.293,69	100%	227%	85%
Ndhimja shtetërore	million Euro	40,70	93,96	34,96	100%	227%	85%
PPB nominal	miliard LEK	896.300	956.314	1.086.000	100%	107%	121%
PPB nominal	million Euro	7.286,00	7.885,00	8.843,00	100%	107%	121%
Ndhimja shtetërore në raport ndaj PPB	%	0,56%	1,19%	0,40%	100%	213%	71%
Shpenzimet gjithsej	miliard LEK	258.816	285.329	350.270	100%	112%	135%
Shpenzimet gjithsej	million Euro	2.092,29	2.342,99	2.852,36	100%	112%	136%
Ndhimja shtetërore në raport ndaj shpenzimeve gjithsej	%	1,95%	4,01%	1,23%	100%	206%	63%
Numri i të punësuarve	million	0,934	0,935	0,970	100%	100%	104%
Ndhimja shtetërore për çdo punonjës	LEK	5.393	12.238	4.426	100%	227%	82%
Ndhimja shtetërore për çdo punonjës	Euro	44	100	36	100%	227%	82%
Numri i të papunëve	million	0,14976	0,143	0,154	100%	95%	103%
Ndhimja shtetërore për çdo të papunë	LEK	33.633	80.091	27.937	100%	238%	83%
Ndhimja shtetërore për çdo të papunë	Euro	272	658	227	100%	238%	83%
Popullsia	million	3,15	3,16	3,17	100%	101%	101%
Ndhimja shtetërore për frymë	LEK	1.601	3.619	1.354	100%	226%	85%
Ndhimja shtetërore për frymë	Euro	13	29	11	100%	226%	85%

Të dhënat në Tabelën 3 përfshijnë edhe ndihmën “*de minimis*”¹⁷.

Nga këto të dhëna, vërehet se ka patur një rritje të nivelit të ndihmës shtetërore për çdo Punonjës në 2007 (afërsisht nga 5,400 lekë në 2006 dhe në 12,000 lekë në 2007), por që ka pësuar sërish ulje, gjatë vitit 2008, në vlerën 4.400 lekë për çdo punonjës. Vihet re e njëjta prirje për ndihmën

¹⁷ *Ndhimja De Minimis*, është ndihma shtetërore me vlerën më pak se 100.000 Euro dhe që jepet për një periudhë jo më të shumë se tre vjetësh. Sipas rregullave të BE-së, (ku, niveli më i lartë i ndihmës “*de minimis*” është 200,000€) ky nivel i mbështetjes nuk konsiderohet si masë që mund të sjellë ndikim në tregti.

shtetërore për frymë (nga 1601 lek në 2006 dhe në 3619 në 2007 dhe 1354 Lek në 2008), si edhe për ndihmën shtetërore për personat e papunë, ku ndihma në vitin 2007 është gati sa dyfishi i vlerës së saj në vitin 2006 dhe është ulur në 2008 deri në 38% dhe 85% të vlerës, përkatësisht, të viteve 2007 dhe 2006. Po kështu, krahasuar me vitin 2006, në 2007 është dyfishuar pjesa e ndihmës shtetërore në raport me shpenzimet totale të Qeverisë ndërsa, në vitin 2008, ky raport është ulur ndjeshëm, madje 11% krahasuar me vitin 2006. Kështu, ndihma shtetërore në vitin 2008 përbënte vetëm 1,73% të shpenzimeve totale të buxhetit.

Referuar metodologjisë së BE-së, ku ndihma shtetërore në bujqësi, peshkim dhe transport monitorohen dhe vlerësohen veçmas, në këtë raport, në tabelën 4, paraqiten të dhënat e ndihmës shtetërore në Shqipëri, në 3 vitet e fundit, duke përjashtuar vlerën e dhënë për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit.

**Tabela 4 : Ndihma shtetërore në Shqipëri për vitet 2006-2008
(përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin)**

Emërtimi	Njësia e matjes	2006	2007	2008
Ndihma shtetërore totale përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin	million LEK	3.318,57	9.435,99	2.619,92
Ndihma shtetërore totale përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin	million Euro	26,81	77,48	21,33
PPB Nominal	miliard LEK	896.300	956.314	1.086.000
PPB Nominal	million Euro	7.286	7.885	8.843
Ndihma shtetërore përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin ndaj PPB	%	0,368	0,983	0,241

Analiza tregon se, duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin, vlera e ndihmës shtetërore në vitin 2008 është 2.62 miliardë lekë. Në vitin 2007 vlera e ndihmës shtetërore, duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin ishte rreth 2,7 herë më e lartë (267%), krahasuar me shifrat e vitit 2006. Ndërsa, vlera e ndihmës shtetërore, duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin në 2008 është ulur jo vetëm në krahasim me 2007, me rreth 3.6 herë, por edhe krahasuar me vitin 2006, pasi vlera totale në vitin 2008 ishte rreth 80% e vlerës së dhënë në vitin 2006.

Pjesa që zë ndihma shtetërore (pa përfshirë sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit) në raport me PPB-në përdoret nga BE për të bërë krahasimet midis shteteve, si dhe për të monitoruar prirjen e vlerës totale të ndihmës shtetërore. Parë në këtë këndvështrim, nivelet nga 0.37% në 0.98% (për vitet 2006 dhe 2007) dhe raporti prej 0.24% në vitin 2008 janë të krahasueshme me mesataren e raportit ndihmë shtetërore/PPB për vendet e BE-së (pa bujqësinë, peshkimin dhe transportin), që është në vlerat 0,4% për vitet 2006 dhe 2007¹⁸.

Krahasimi për vitet 2006 dhe 2007 jepet në tabelën 5. Duket qartë se zhvillimet në vitin 2007, janë një përjashtim nga prirja e përgjithshme, gjë që është analizuar në detaje në raportin vjetor të mëparshëm.

¹⁸ http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.cfm.

Tabela 5: Ndhimja shtetërore në Shqipëri në total për vitet 2006-2007 (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin) krahasuar me mesataren në BE dhe nivelet e Shteteve Anëtare të BE-së¹⁹.

Emri i shteteve	2006		2007	
	mln Euro	GDP %	mln Euro	GDP %
Shqipëria	26,81	0,37	77,48	0,98
EU27	51740,3	0,4	49213,6	0,40
EU15	47691,1	0,4	45405,9	0,40
EU12	4049,1	0,5	3807,7	0,43
Belgjika	956,8	0,3	882,6	0,27
Bullgaria	33,8	0,1	27,0	0,09
Çekia	600,9	0,5	766,6	0,60
Danimarka	1034,9	0,5	1166,3	0,51
Gjermania	16692,8	0,7	14147,6	0,58
Estonia	11,8	0,1	10,4	0,07
Irlanda	603,8	0,3	602,7	0,32
Greqia	406,8	0,2	551,0	0,24
Spanja	3703,9	0,4	4335,8	0,41
Franca	7285,9	0,4	6888,6	0,37
Italia	5406,3	0,4	3860,1	0,25
Qipro	72,3	0,5	62,5	0,24
Letoni	28,7	0,2	42,4	0,21
Lituani	57,9	0,2	50,4	0,18
Luksemburg	46,5	0,1	46,4	0,13
Hungaria	870,3	0,9	879,4	0,87
Malta	88,5	0,7	74,1	0,59
Hollanda	1419,7	0,3	1354,7	0,24
Austria	1729,0	0,7	815,4	0,30
Polonia	1265,9	0,5	1260,8	0,41
Portugalia	1438,0	0,9	2118,9	1,30
Rumania	659,0	0,6	296,3	0,24
Sllovenia	152,6	0,5	114,8	0,34
Sllovakia	207,5	0,5	222,8	0,41
Finlanda	623,3	0,4	628,8	0,35
Suedia	2932,8	0,9	2932,4	0,88
Anglia	3410,9	0,2	5074,7	0,25

Nëse i referohemi vlerës totale të ndihmës të shprehur në euro (pa përfshirë sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit), tabela tregon se ndihma shtetërore në Shqipëri ka qenë më e ulët se niveli i saj në secilin prej shteteve anëtare të BE-së (duke përfshirë shtetet e vogla anëtare, me popullsi të përafërt me atë të Shqipërisë), me përjashtim të Estonisë për vitin 2006.

Prirja e Shqipërisë ka ndryshuar në vitin 2007, ku treguesi i raportit të ndihmës shtetërore kundrejt PPB-së ka qenë më i lartë se nivelet e 27 shteteve anëtare të BE-së. Ky rezultat është përmbysur sërish në vitin 2008 vit, në të cilin, ky tregues ka qenë sa mesatarja e vendeve të BE-së.

¹⁹ Të dhëna nga BE-ja dhe shtetet anëtare të BE-së: http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.cfm.

Kategoritë e ndihmës shtetërore

Duke ndjekur metodologjinë e BE-së për raportimin e ndihmës shtetërore, në këtë raport janë paraqitur të dhënat për kategoritë e mëposhtme të ndihmës shtetërore: ndihma horizontale, ndihma sektoriale (vertikale), ndihma “Ad-hoc” dhe ndihma shtetërore për sektorët e bujqësisë dhe peshkimit.

Ndihma horizontale është e zbatueshme për të gjitha ndërmarrjet dhe sektorët (që tentojnë të shtrembërojnë më pak konkurrencën në treg) dhe ndihma për sektorët e veçantë apo ajo që u jepet vetëm disa ndërmarrjeve që veprojnë në sektorë të caktuar të industrisë. Ndihma horizontale përfshin kategoritë që, kryesisht, synojnë të nxitin zhvillimin rajonal, kërkimin dhe zhvillimin, mbrojtjen e mjedisit dhe kursimin e energjisë, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, punësimin, trajnimin dhe kulturën.

Ndihma sektoriale i referohet ndihmës shtetërore që jepet për sektorë të veçantë, (duke përfshirë sektorin e transportit, shërbimet publike, transmetimet televizive, minierat dhe turizmin).

Ndihma Ad-Hoc është ndihma që projektohet për/dhe i jepet vetëm një ndërmarrjeje përfituese.

Ndihma shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore, gjë që është përcaktuar edhe në MSA.

Tabela 6 paraqet të dhënat për kategoritë e mësipërme të ndihmës shtetërore në Shqipëri.

Tabela 6 : Ndihma Shtetërore në Shqipëri (duke përfshirë sektorët e bujqësisë dhe peshkimit) për vitet 2006-2008


Kategoria e ndihmës		2006			2007			2008		
		mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		123,70			121,78			122,80		
A	Ndihmat horizontale	1.022,20	8,26	20,30	2.674,44	21,96	23,37	728,67	5,93	16,97
	1 Ndihma rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	2 Punësimi	68,25	0,55	1,4	77,60	0,64	0,68	80,20	0,65	1,87
	3 Kultura	225,00	1,82	4,5	121,07	0,99	1,06	-	-	-
	4 Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	5 Eksporti	-	-	-	-	-	-	2,12	0,02	0,05
	6 Ndihma operacionale	71,74	0,58	1,4	67,56	0,55	0,59	326,63	2,66	7,61
	7 Shpëtimi dhe ristrukturimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	8 Kërkimi dhe Zhvillimi	545,09	4,41	10,8	317,60	2,61	2,78	175,91	1,43	4,10
	9 SME-të	-	-	-	2,40	0,02	0,02	12,80	0,10	0,30
	10 Sporti	80,00	0,65	1,6	48,61	0,40	0,42	-	-	-
	11 Trainimi	32,12	0,26	0,6	39,60	0,33	0,35	131,00	1,07	3,05
	12 Ndihma sociale për konsumatorë individualë	-	-	-	2.000,00	16,42	17,478	-	-	-
B	Sectoral (vertical) aid	3.097,36	25,03	61,48	2.496,05	20,50	21,81	2.629,02	21,41	61,23
	12 Transporti publik	801,00	6,48	15,91	734,50	6,03	6,419	737,77	6,01	17,18
	13 Shërbimet publike	2.083,20	16,84	41,37	1.619,13	13,30	14,150	1.454,38	11,84	33,87
	14 Minierat	158,00	1,28	3,14	-	-	-	56,92	0,46	1,33
	15 Energjia	50,31	0,41	1,00	120,66	0,99	1,055	377,06	3,07	8,78
	16 Audio-Vidio	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	17 Televizionet/mediat	2,86	0,02	0,06	2,86	0,02	0,025	2,89	0,02	0,07
	19 Turizmi	2,00	0,002	0,00	18,90	0,16	0,165	-	-	-
C	Ndihma Individuale	-	-	-	5.000,00	41,06	43,696	-	-	-
D	Bujqësia	917,30	7,42	18,22	1.272,18	10,45	11,118	936,00	7,62	21,80
TOTALI		5.036,87	40,70	100	11.442,67	93,96	100	4.293,69	34,96	100

Siç vihet re në tabelën 6, për vitet 2006-2008, pjesën më të madhe e zë ndihma sektoriale vertikale) me rreth 48% të vlerës totale për periudhën 3-vjeçare. Në ndihmën vertikale, shërbimet publike zënë 62,7% të të gjithë ndihmës sektoriale në këtë periudhë. Ndërsa ndihma për energjinë llogaritet në 6.7% të të gjithë ndihmës sektoriale për të njëjtën periudhë, megjithatë, po të shtojmë në të ndihmën “Ad hoc”, vlera e ndihmës shtetërore për sektorin e energjisë shkon në 26,7% të vlerës totale të ndihmës shtetërore. Për më tepër, ndihma shtetërore për sektorin hekurudhor, energjinë (duke përfshirë dhe ndihmën Ad-hoc) dhe sektorin e ujësjellës-kanalizimeve mbizotëron në vlerën e përgjithshme të ndihmës shtetërore në Shqipëri, duke zënë 67% të totalit të ndihmës së dhënë gjatë periudhës 3 vjeçare.

Në vitin 2007, vlera e ndihmës horizontale është trefishuar krahasuar me 2006, ndërsa në vitin 2008 ajo zbriti me 29% edhe krahasuar me vitin 2006. Megjithatë, ndihma horizontale për vitin 2007 ka pësuar shmangie, si rezultat i zbatimit të një skeme të vetme, asaj të ndihmës me karakter social për konsumatorët individualë, që përbën 45% të ndihmës horizontale për të gjithë periudhën 3 vjeçare. Kjo masë lidhet me subvencionin që iu është dhënë kategorive të veçanta të konsumatorëve (si p.sh të moshuarit), të zbatuar gjatë vitit 2007 për shkak të krizës energjetike në Shqipëri.

Të dhënat për të gjitha kategoritë e ndihmës shtetërore, paraqiten grafikisht në figurën 1.

Figura 1: Ndhima Shtetërore (në milion lekë) për vitet 2006, 2007 dhe 2008



Ndërsa tabela 7 paraqet ndihmat e dhëna në Shqipëri, gjatë së njëjtës periudhë, por duke përjashtuar ndihmën shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin.

Tabela 7: Klasifikimi sipas kategorive i ndihmës shtetërore për vitet 2006-2008
(përfshijë bujqësinë dhe peshkimin)

Kategoria e ndihmës		2006			2007			2008		
		mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)
kursi mesatar i këmbimit		123,70			121,78			122,80		
A	Ndihmat horizontale	1.022,20	8,26	24,82	2.674,44	21,96	26,30	728,67	5,93	21,70
	1 Ndihma rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	2 Punësimi	68,25	0,55	1,66	77,60	0,64	0,76	80,20	0,65	2,39
	3 Kultura	225,00	1,82	5,46	121,07	0,99	1,19	-	-	-
	4 Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	5 Eksporti	-	-	-	-	-	-	2,12	0,02	0,06
	6 Ndihma operacionale	71,74	0,58	1,74	67,56	0,55	0,66	326,63	2,66	9,73
	7 Shpëtimi dhe ristrukturimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	8 Kërkimi dhe Zhvillimi	545,09	4,41	13,24	317,60	2,61	3,12	175,91	1,43	5,24
	9 SME-të	-	-	-	2,40	0,02	0,02	12,80	0,10	0,38
	10 Sporti	80,00	0,65	1,94	48,61	0,40	0,48	-	-	-
	11 Trainimi	32,12	0,26	0,78	39,60	0,33	0,39	131,00	1,07	3,90
	12 Ndihma sociale për konsumatorë individualë	-	-	-	2.000,00	16,42	19,66	-	-	-
B	Sectoral (vertical) aid	3.097,36	25,03	75,18	2.496,05	20,50	24,54	2.629,02	21,41	78,30
	12 Transporti publik	801,00	6,48	19,452	734,50	6,03	7,222	737,77	6,01	21,97
	13 Shërbimet publike	2.083,20	16,84	50,590	1.619,13	13,30	15,920	1.454,38	11,84	43,31
	14 Minierat	158,00	1,28	3,837	-	-	-	56,92	0,46	1,70
	15 Energjia	50,31	0,41	1,222	120,66	0,99	1,186	377,06	3,07	11,23
	16 Audio-Vidio	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	17 Televizionet/mediat	2,86	0,02	0,069	2,86	0,02	0,028	2,89	0,02	0,09
	19 Turizmi	2,00	0,0020	0,0059	18,90	0,16	0,186	-	-	-
C	Ndihma Individuale	-	-	-	5.000,00	41,06	49,162	-	-	-
TOTAL		4.119,57	33,29	100	10.170,49	83,52	100	3.357,69	27,34	100

Instrumentet e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore në Shqipëri jepet, kryesisht, në formën e granteve dhe të përjashtimit të uljes së taksave. Në mënyrë të përmblëdhur, të dhënat për periudhën 2006-2008 paraqiten në tabelën 8.

Tabela 8: Ndihma Shtetërore në Shqipëri e klasifikuar sipas instrumenteve


Kategoria e Instrumenteve	Instrumentat e Ndhmës Shtetërore	Treguesit	2006	2007	2008
A1	Subvencione dhe Grante	%	83,74	95,00	73,65
		lek	3.447,57	9.661,81	2.473,07
		eur	27,87	79,34	20,14
A2	Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale	%	16,19	4,97	26,20
		lek	667,14	505,82	879,61
		eur	5,39	4,15	7,16
B	Pjesmarrja në kapital	%	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-
C1	Hua të buta	%	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-
C2	Të tjera instrumente	%	0,07	0,03	0,09
		lek	2,86	2,86	2,89
		eur	0,08	0,02	0,02
D	Garancitë	%	-	-	0,06
		lek	-	-	2,12
		eur	-	-	0,02

Grupi "Instrumente të tjerë (C2)" i referohet dhënies me qera të pronave shtetërore me çmime më të ulta se çmimi i tregut, në bazë të një skeme²⁰, cila ishte shfuqizuar para hyrjes në fuqi të legjislacionit të ndihmës shtetërore. Kjo skemë vazhdon të paraqitet në të dhënat, pasi ka ende disa kontrata të lidhura që vazhdojnë të zbatohen.

Vihet re përdorimi, në vitin 2008, të instrumentit të garancisë shtetërore, si efekt i drejtpërdrejtë i zbatimit të "Fondit të Garantimit të Kredive të Eksportit", të miratuar nga KNSH në vendimin e tij nr. 16, datë 16.07.2007.

Grafikisht, përdorimi i instrumenteve të ndihmës shtetërore në Shqipëri është paraqitur në Figurën 2.

Figura 2: Ndihma shtetërore sipas instrumenteve (në milion lekë) për vitet 2006, 2007 dhe 2008



Siç shihet edhe nga figura 2, në vitin 2008, në krahasim me 2007 dhe 2006, ka një rënie në sasinë dhe peshën që kanë zënë grantet ndaj totalit të ndihmës shtetërore dhe një rritje të përdorimit të instrumenteve të tjerë, në veçanti atij të përjashtimit nga taksat dhe uljes së tyre. Ky ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i zbatimit gjatë gjithë vitit të skemave për shtyrjen e pagesës së TVSH-së së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a, të miratuara më parë me vendim nr. 17, datë 16/07/2007 të KNSH. Efekti monetar që rezultoi nga zbatimi i këtyre skemave në vitin 2008 ishte 623,151 milion lekë.

²⁰ VKM nr. 430, datë 9.7.1998, "Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore", VKM nr. 315, datë 24.4.2003" Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore"

Ndihma horizontale në Shqipëri


Tabela 9 paraqet, në mënyrë të detajuar të dhënat e ndihmës horizontale, sipas qëllimit të përdorimit, për periudhën 2006-2008.

Tabela 9: Shpërndarja e ndihmave horizontale në Shqipëri

Ndihma Horizontale	2006		2007		2008		Total	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		123,70		121,78		122,80		
Punësimi	68,25	0,55	77,60	0,64	80,20	0,65	226,05	1,84
Kultura	225,00	1,82	121,07	0,99	-	-	346,07	2,81
Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-
Eksporti	-	-	-	-	2,12	0,02	2,12	0,02
Ndihma shtetërore operacionale	71,74	0,58	67,56	0,55	326,63	2,66	465,93	3,79
Shpëtim dhe Ristrukturim	-	-	-	-	-	-	-	-
Kërkim dhe Zhvillim	545,09	4,41	317,60	2,61	175,91	1,43	1.038,61	8,45
SME-të	-	-	2,40	0,02	12,80	0,10	15,20	0,12
Sporti	80,00	0,65	48,61	0,40	-	-	128,61	1,05
Trajnimi	32,12	0,26	39,60	0,33	131,00	1,07	202,72	1,65
Ndihma sociale për konsumatorë individualë	-	-	2.000,00	16,42	-	-	2.000,00	16,42
Total	1.022,20	8,26	2.674,44	21,96	728,67	5,93	4.425,30	36,16

Siç është analizuar edhe më parë, 75% e ndihmës horizontale të dhënë gjatë vitit 2007, përfaqëson ndihmën sociale për konsumatorët individualë. Kjo ndihmën sociale për subvencionimin e energjisë për konsumatorët individualë që lidhet me subvencionin që iu është dhënë kategorive të veçanta të konsumatorëve (si p.sh të moshuarit), i aplikuar gjatë vitit 2007 për shkak të krizës energjetike në Shqipëri. Kjo skemë nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2008, ku del qartë se vlera totale e ndihmës horizontale ka rënë ndjeshëm, madje nën nivelin e vitit 2006. Grafiku 3 paraqet ndihmën horizontale në Shqipëri për periudhën 2006-2008.

Figura 3: Ndihma horizontale (në milion Lek) për vitet 2006-2008




Vlera totale e ndihmës horizontale dhënë në vitin 2006 pothuajse është trefishuar në vitin 2007, por më e ulët në vitin 2007, nëse përjashtohet masën e ndihmës sociale. Pjesën më të madhe në periudhën 3 vjeçare, duke marrë parasysh edhe masën e ndihmës sociale, e zënë përjashtimet nga taksat për sektorin e hidrokarbureve (komponenti i kërkimit dhe zhvillimit), i llogaritur në 43% të totalit të ndihmës horizontale, më pas ndihma operacionale (19%), ndihma për mbështetjen e kulturës (14%) dhe ndihma për punësim dhe trajnim (së bashku 17%).

Ndihma për SME-të u paraqit për herë të parë në vitin 2007 dhe ka pasur një rritje deri në 5 herë në vitin 2008, për shkak të aplikimit të Skemës për Fondin e Konkurrueshmërisë. Megjithatë, kjo kategori llogaritet vetëm 1,76% të totalit të ndihmës horizontale.

Në figurën 4. është paraqitur shpërndarja e ndihmës horizontale, sipas kategorive, për vitin 2008.

Figura 4: Ndihma horizontale për vitin 2008



Gjatë gjithë periudhës 2006-2008, ndihma horizontale, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin, përfaqësonte 21% të ndihmës shtetërore të dhënë dhe, nëse përjashtojmë bujqësinë dhe peshkimin, 25% të totalit të ndihmës shtetërore në vend. Nëse nga këto llogaritje zbresim edhe vlerën e subvencionit për energjinë, dhënë në vitin 2007 për konsumatorët individualë, gjatë periudhës 2006-2008, ndihma horizontale përbën 23.6% të totalit të ndihmës, bashkë me sektorët e bujqësisë dhe peshkimit dhe 28.3%, duke përjashtuar këta sektorë.

Pjesa që zë ndihma horizontale në raport me totalin e ndihmës në vend, (duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin), për vitet 2006 dhe 2007, krahasuar me mesataren e këtyre kategorive në BE dhe në secilin prej shteteve anëtare, paraqitet në tabelën 10.

Tabela 10: Ndhimja horizontale në raport me totalin e ndihmës shtetërore në Shqipëri si dhe krahasimi me mesataren e BE-së dhe shteteve të saj anëtare për vitet 2006 dhe 2007 (në %)²¹.

Emri i shtetit	2006	2007
Shqipëria	20	23
EU-totali	83	80
EU-15	84	80
EU-10 dhe Bullgaria dhe Rumania	73	77
Belgjika	98	100
Bullgaria	79	92
Çekia	100	100
Danimarka	96	92
Gjermania	85	79
Estonia	100	100
Irlanda	79	77
Greqia	98	98
Spanja	72	74
Franca	96	95
Italia	75	89
Qipro	96	95
Letoni	100	100
Lituani	100	96
Luksemburg	100	100
Hungaria	48	53
Malta	5	4
Hollanda	98	96
Austria	54	98
Polonia	85	89
Portugalia	13	10
Rumania	49	36
Slovenia	88	84
Slovakia	95	76
Finlanda	97	96
Suedia	99	99
Anglia	91	62

Siç mund të shihet, ndihma shtetërore horizontale në BE, përfaqëson më shumë se 80% të totalit të ndihmës shtetërore, ndërkohë që në Shqipëri ka qenë 20% në vitin 2006 dhe 23% në vitin 2007. Nëse bëhet krahasimi me Shqipërinë, për të dyja vitet, të gjitha shtetet anëtare të BE-së (me përjashtim të Portugalisë dhe Maltës), kanë pasur vlera më të larta të ndihmës shtetërore horizontale në raport me totalin e ndihmës së dhënë. Për vitin 2008, siç u paraqit ndihma horizontale ka zënë vetëm 17% të totalit të ndihmës shtetërore, duke e ulur edhe më tej këtë raport.

Deri tani, në Shqipëri nuk është zbatuar ndonjë skemë e ndihmës rajonale. Nisur nga ky fakt, si dhe duke marrë parasysh masën e madhe të ndihmës shtetërore, të dhënë për përballimin e krizës energjetike në Shqipëri, në formën e ndihmës sektoriale, bëhet i kuptueshëm niveli relativisht i ulët i ndihmës shtetërore horizontale kundrejt totalit të ndihmës në Shqipëri. Megjithatë, në të ardhmen, duke iu referuar strategjisë së zhvillimit rajonal, si dhe duke pasur parasysh që kriza energjetike është në rënie, ekziston mundësia që ky raport të ndryshojë

²¹ Të dhëna nga BE dhe shtetet anëtare të BE-së: http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.cfm.

Ndihma Sektoriale / Vertikale në Shqipëri

Tabela 11 paraqet të dhënat e përgjithshme të ndihmës vertikale në Shqipëri dhe shpërndarjen sipas sektorëve të veçantë (duke përjashtuar bujqësinë dhe peshkimin), gjatë periudhës 2006 deri në 2008.

Tabela 11. Shpërndarja e Ndihmave Vertikale në Shqipëri

Ndihma sektoriale (vertikale)	2006		2007		2008		Total	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		123,70		121,78		122,80		
Transporti publik	801,00	6,48	734,50	6,03	737,77	6,01	2.273,27	18,51
Shërbime publike	2.083,20	16,84	1.619,13	13,30	1.454,38	11,84	5.156,71	41,98
Minerat	158,00	1,28			56,92	0,46	214,92	1,74
Energjia	50,31	0,41	120,66	0,99	377,06	3,07	548,03	4,47
Audio	-	-	-	-	-	-	-	-
Televizionet/mediat	2,86	0,02	2,86	0,02	2,89	0,02	8,61	0,07
Tourismi	2,00	0,02	18,90	0,16	-	-	20,90	0,17
TOTAL	3.097,37	25,04	2.496,05	20,50	2.629,02	21,41	8.222,44	66,94

Pjesa më e madhe e ndihmës sektoriale në Shqipëri, gjatë periudhës 2006-2008, është dhënë për shërbimet publike (63%). Në vlerë, ndihma sektoriale llogaritet në masën 8.2 miliardë lekë (ose 66,9 milionë €). Ndihma shtetërore për shërbimet publike gjatë kësaj periudhe përfshin, në veçanti, mbështetjen e qeverisë për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe që është dhënë për të përballuar një pjesë të kostove operacionale²², si dhe skemën e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për ndërmarrjet me kapital shtetëror. Kjo skemë ka mundësuar mbështetjen për ndërmarrjet me kapital shtetëror, duke iu ulur atyre detyrimin e regjistruar në bilanc, kryesisht, për sektorin e ujësjellsave dhe atë të minierave.

Për sa i takon sektorit të transportit, ndihma shtetërore është dhënë për mbështetjen e transportit hekurudhor, i cili ka pësuar një rënie në kohë²³. Mbështetja e shtetit për minierat ka pasur gjithashtu një rënie të dukshme gjatë viteve 2006 dhe 2008 (ndihma shtetërore është ndërprerë në vitin 2007 në këtë sektor). Pjesa më e vogël e ndihmës sektoriale në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe, lidhet me industrinë e turizmit (0.25%) dhe sektorin e transmetimit/mediatik (0.1%)²⁴.


Ndihma Sektoriale në Shqipëri është paraqitur grafikisht në Figurën 5.

²² Rishikimi i skemës ekzistuese për subvencionimin e ujësjellës-kanalizimeve sipas Vendimit të KNSH-s kërkon një reduktim progresiv të ndihmës shtetërore dhe klasifikimi si shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik. Këto masa u pranuan nga autoritetet përgjegjëse në Shqipëri (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme) dhe po monitorohen nga DNSH.

²³ Ndihma shtetërore për transportin hekurudhor ka si qëllim kompensimin për kostot e ofrimit të shërbimit publik. Qëndrimi i KNSH-së është: rishikimi i ndihmës shtetërore për transportin hekurudhor në Shqipëri, një kontratë publike për shërbimin publik të transportit të udhëtarëve, e cila u nënshkrua në korrik të 2007, si dhe ndarja e llogarive, kushte të vendosura nga KNSH, të cilat po ndiqen nga DNSH.

²⁴ Bëhet fjalë për një përfitues të vetëm të një qeraje shtetërore nën çmimet e tregut sipas një skemë, të shfuqizuar para hyrjes në fuqi të legjislacionit për ndihmën shtetërore në Shqipëri.

Figura 5: Ndihma Sektoriale (në milion Lek) për vitet 2006, 2007 dhe 2008



Në kushtet kur Qeveria Shqiptare po ndërmerr një sërë nismash që synojnë përmirësimin e infrastrukturës në vend dhe klimën e biznesit, mbështetja e shtetit për sektorin e transportit hekurudhor, sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe sektorin e energjisë synon të reduktohet në vite.

Ndihma “Ad hoc”

Në ndryshim nga viti 2007, gjatë vitit 2008 nuk është evidentuar ndonjë rast i përdorimit të ndihmës “Ad hoc” për mbështetjen e ndërmarrjeve të caktuara.

KAPITULLI 4

KONKLUZIONE

Raporti i dytë vjetor për ndihmat shtetërore, i paraqitur nga Republika e Shqipërisë për BE-në dhe CEFTA-n, vjen si një zbatim i detyrimeve të sanksionuara në MSA dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2008, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2006-2008.

Raporti nënvizon faktin se ndihma totale në Shqipëri për vitin 2008 është 4.3 miliardë lekë. Kjo shumë është 85% e vlerës së ndihmës së dhënë gjatë vitit 2006 (5 miliardë Lek) dhe rreth 2,7 herë më e ulët se ndihma shtetërore e dhënë në vitin 2007 (11.5 miliardë Lek).

Të dhënat e paraqitura në raport për periudhën 2006-2008, tregojnë se ndihma shtetërore në Shqipëri shkon nga 0.56% të PPB-së në vitin 2006, në 1,2% të PPB-së për vitin 2007 dhe një rënie në 0.4% të PPB-së për vitin 2008. Nëse do të përjashtojmë ndihmën e dhënë për bujqësinë, peshkimin dhe sektorin e transportit, ndihma shtetërore zë 0.368% të PPB-së në 2006, 0,983% në 2007 dhe 0,24% në 2008. Këto nivele të ndihmës shtetërore janë të arsyeshme për rrethanat e Shqipërisë, gjë që bëhet më e qartë nëse i krahasojmë me nivelet mesatare të ndihmës shtetërore të shteteve të BE-së, në raport me PPB-në e tyre (duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin), që zënë, mesatarisht, 0,4%.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore për periudhën e trajtuar në këtë raport, kanë qenë grantet, përjashtimi dhe ulja e taksave. Për herë të parë në vitin 2008 janë përdorur si instrument edhe garancitë shtetërore, pavarësisht se në vlerë të ulët (vetëm 2,12 mln lek)

Pesha e ndihmës shtetërore horizontale gjatë periudhës 3 vjeçare ishte shumë e ulët, 19.74% ndaj totalit të ndihmës shtetërore duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin ose 24,27%, duke përjashtuar bujqësinë dhe peshkimin. Pra, rreth 80% e ndihmës shtetërore është dhënë për të mbështetur sektorët e veçantë (ndihma sektoriale, përfshirë bujqësinë) apo në formën e ndihmës *Ad-hoc*. Pjesa më madhe e ndihmës shtetërore sektoriale në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2008 është dhënë për shërbimet publike (63%).

Megjithatë ka një prirje për ndryshimin e këtij raporti. Treguesit e parë janë dhënë nëpërmjet zbatimit të skemave për rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, apo për mbështetjen afatshkurtër të tyre, nëpërmjet garantimit të kapitalit punues. Po kështu, skemat e punësimit apo të formimit profesional po sjellin ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e shkallës së punësimit dhe integrimin në tregun e punës të shtresave të caktuara të shoqërisë. Objektivat e rinj strategjikë, që synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe klimës së biznesit, si dhe përmirësimin e edukimit, trajnimit, inovacionit dhe kreativitetit në biznes do të mundësojnë ndryshimin e raportit midis kategorive të ndryshme të ndihmës, duke vënë theksin në kategoritë e ndihmës horizontale. Kështu, dhënia e ndihmës shtetërore në Shqipëri, duket parë e lidhur ngushtë me një kuadër mjaft dinamik të zhvillimit ekonomik, i cili pritet të sjellë ndryshime të shpejta në këto raporte. I gjithë ky proces do të paraprihet nga politika të matura dhe do të zhvillohet nën një mbikëqyrje sistematike, gjë që bëhet edhe më e evidente në kushtet e krizës aktuale botërore.

ANEKS :Të dhënat e ndihmës shtetërore në shqipëri për periudhën 2006-2007

Shteti	Dhënësi i ndihmës	Titulli origjinal	Numri i ndihmës	Viti i vendimit	Objektivi primar	Sektori	Lloji i ndihmës	Instrumenti i ndihmës	Përshkrimi i ndihmës	Fillimi i skemës	bashkë-financim	2006 (Milion LEK)	2007 (Milion LEK)	2008 (Milion LEK)
AL	Ministria e Financave	-	-	-	Shlyerje te detyrimeve te prapambetura	-	H	Grante nga buxheti i shtetit	Grant	cdo vit	jo	-	5.000,00	-
AL	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	-	-	-	Ndihma sociale për konsumatorët individual	-	H	Grante nga buxheti i shtetit	Grant	cdo vit	jo	-	2.000,00	-
AL	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës (METE)	-	-	-	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (Qeratë)	-	H	Lehtësira	Lehtësira		jo	74,60	69,60	83,31
AL	Turizmi, Kultura dhe Sportet	-	-	-	Zhvillimi ekonomik	-	S	Grante nga buxheti i shtetit	Grant	cdo vit	jo	307,00	188,58	-
AL	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT)	Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit	AI/014/2005	Nr. 5, date 20.10.2006	Mbulimi i një pjesë të kostove operative: pagat, sigurimet shoqërore, blerjen e lëndëve kimike dhe shpenzimet për energjinë elektrike	Ujësjellës-Kanalizime	S	Subvencione nga buxheti i shtetit	Grant	2001	jo	785,14	760,90	854,38
AL	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT)	Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave	AI/015/2005	Nr. 8, date 2.02.2007, Nr.15, datë 15.03.2007	Kompensimi i kostove të ofrimit të shërbimeve publike, në veçanti, mbulimin e shpenzimeve operative të shërbimit të transportit të udhëtarëve	Transporti Hekurudhor	S	Subvencione nga buxheti i shtetit	Grant	2001	jo	801,00	734,50	737,77
AL	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB)	Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë"	AI/006/1/2005	Nr. 11, date 15.03.2007	Nxitjen e punësimit	Punësimi	H	Subvencione nga buxheti i shtetit	Grant	1999	jo	1,01	1,30	13,00
AL	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB)	Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"	AI/006/2/2005	Nr. 12, date 15.03.2007	Nxitjen e punësimit	Punësimi	H	Subvencione nga buxheti i shtetit	Grant	1999	jo	28,10	24,50	131,00
AL	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB)	Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional"	AI/006/3/2005	Nr. 13, date 15.03.2007	Nxitjen e punësimit	Trainimi	H	Subvencione nga buxheti i shtetit	Grant	1999	jo	32,12	39,60	
AL	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë femra"	AI/006/4/2005	Nr. 14, date 15.03.2007	Nxitjen e punësimit	Punësimi	H	Subvencione nga buxheti i shtetit	Grant	2003	jo	39,14	51,80	49,30
AL	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Për skemën ekzistuese, ligjin nr. 7665, datë 21.01.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" shfuqizuar me ligjin nr. 9734, datë 14. 05. 2007 "Për turizmin"	AI/004/2005	Nr.18, Date 1.11.2007	Nxitja e investimeve në sektorin e turizmit	Turizmi	S	Përrjashtimi nga taksa e transferimit mbi dividendët, nga taksa doganore dhe akcizat mbi mallrat e sendet e importuara, nga tatimi mbi fitimin, etj...	Ndihma fiskale	2007	jo	-	-	-
AL	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës (METE)	Për skemën ekzistuese, ligjin nr. 7973, datë 26.07.1995 "Për koncesionet", shfuqizuar me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet"	AI/003/2005	Nr. 19, Date 01.11.2007	Nxitja e investimeve			Përrjashtim nga taksat mbi fitimin, tarifat doganore, taksat e qarkullimit, taksat mbi importet, reduktim i taksave, garanci të ndryshme shtetërore, si: sigurimi i aseteve, garantimi i blerjes së mallrave apo shërbimeve, etj.	Ndihma fiskale	2006	jo	-	-	0,12

AL	Ministria e Ekonomisë, Tregëstisë dhe Energjetikës (METE)	Për skemën ekzistuese ligjin nr. 8636, datë 06.07.2000 "Për zonat e lira" amenduar me ligjin nr. 9789, datë 19.07.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike"	AI/007/2005	Nr. 20, date 1.11.2007	Shfrytëzimi i burimeve e potencialeve në nivel lokal e kombëtar, rritjen e fuqisë konkuruese të bizneseve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në tregtinë ndërkombëtare, rritjen e nivelit të prodhimit, eksporteve, shërbimeve e punësimit, nxitjen e investimeve dhe transferimin e teknologjive të avancuara		H	Përfshirja nga taksat doganore, TVSH dhe tatimi mbi fitimin për 10 vjetët e para të veprimtarisë	Ndihma fiskale	2007	jo	-	-	-
AL	Ministria e Financave	Për skemën ekzistuese të pagesës së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror	AL/013/2005	Nr. 21, date 1.11.2007	Lehtësimi i aktiviteteve ekonomike të shërbimeve të Interesit të Përgjithshëm Ekonomik	Ujësjetës- Kanalizime dhe Minierat	S	Grante nga buxheti i shtetit	Grant	2002	jo	1.456,06	858,24	656,92
AL	Ministria e Ekonomisë, Tregëstisë dhe Energjetikës (METE)	Për skemën ekzistuese të përfshirimit të operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH	AI/002/2005	Nr. 22, date 12.12.2007	Zhvillimin e sektorëve strategjikë, nxitja e investimeve në sektorin hidrokarbur	Kërkim- Zhvillimi i Hidrokarbur	H	Përfshirja i pajisjeve dhe makinerive nga taksat doganore dhe TVSH	Ndihma fiskale	1996	jo	545,09	317,60	175,91
AL	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta (MPCSSHB)	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuarët e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit	AI/N/002/2006	Nr. 9, date 02.02. 2007	Nxitjen e punësimit	Punësimi	H	Grant	Subvencion nga buxheti i shtetit	2007	jo	-	-	17,90
AL	Ministria e Ekonomisë, Tregëstisë dhe Energjetikës (METE)	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin "Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë"	AI/N/003/2007	No. 10, date 02.02.2007	Rritjen e shkallës së konkurueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	H	Grant	Subvencion nga buxheti i shtetit	2007	jo	-	2,40	12,80
AL	Ministria e Ekonomisë, Tregëstisë dhe Energjetikës (METE)	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "për fondin e garantimit të kredive të eksportit	AI/N/004/2007	No. 16, date 16.07.2007	Rritjen e shkallës së konkurueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	H	Garanci e Huasë	Garanci e Huasë	2007	jo	-	-	2,12
AL	Ministria e Financave	Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a	AI/N/005/2007	Nr. 17, date 16.07.2007	Të lehtësojë biznesin që kërkon të investojë, duke i dhënë një kohë të mjaftueshme për vënien në shfrytëzim të makinerive dhe pajisjeve dhe shlyerjen e mëtejshme të pagesës së TVSH-së, si dhe të krijojë mundësinë për KESH sh.a, për të përballuar importin e energjisë, në kushtet e vështirësive të sektorit	Energjia	S	Shtyrje e TVSH	Ndihma fiskale	2007	jo	50,31	121,48	623,15

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 15.7.2009
 Doli nga shtypi më 17.7.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë